



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Seksioni 2: Udhëzime për Ofertuesit ose Konsulentët

1. Përmbajtja

1.	Përmbajtja	1
2.	Përkufizimet.....	2
3.	Dispozitat e Përgjithshme.....	2
4.	Konflikti i Interesit	3
5.	Avantazhi i padrejtë konkurrues	3
6.	Mashtrimi dhe Korrupsioni.....	3
7.	Struktura dhe Përmbajtja e Dosjes së Tenderit	3
8.	Orari i parashikuar	3
9.	Pjesëmarrja.....	4
10.	Sqarime.....	4
11.	Ndryshimi i ofertës	4
12.	Përgatitja e ofertës.....	4
13.1.	Kosto.....	4
13.2.	Gjuha	5
13.	Formulari i Dorëzimit të Ofertës	5
14.	Formati dhe Përmbajtja e Ofertës Teknike	5
15.	Oferta Financiare	5
16.	Valuta.....	5
17.	Dokumente që Përcaktojnë të Drejtat dhe Kualifikimet e Ofertuesit	5
17.1.	Formulari i Dorëzimit të Ofertës	5
17.2	Refuzimi i ofertave	5
17.3	Arsyet e tjera për refuzimin e ofertave.....	6
18.	Periudha e Vlefshmërisë	6
19.	Dorëzimi, Hapja dhe Vlerësimi	6
19.1.	Dorëzimi	6
19.2	Hapja e ofertave	6
19.3	Ekzaminimi paraprak i ofertës.....	7
19.4	Vlerësimi i ofertës	7
19.5	Vlerësimi Financiar	7
20.	Tërheqja, Zëvendësimi dhe Modifikimi i Ofertës	8
21.	Konfidencialiteti.....	8
22.	Dhënia e Kontratës.....	8
22.1	E drejta për të pranuar, refuzuar ose për të paraqitur si të papërgjegjshme ndonjë ose të gjitha ofertat.....	8
22.2	Kriteret e dhënies	8
22.3	Nënshkrimi i Kontratës	8
22.4	Komentet për ofertuesit e pasuksesshëm	9
22.5	Ankesat	9

2. Përkufizimet

Ky seksion ofron udhëzime të hollësishme që duhet të ndiqen për t'iu përgjigjur kësaj Ftese për Tender (ITT). Përfshihen Udhëzime dhe Informacione për Autoritetin Kontraktues.

- i. "Autoriteti Kontraktues" i referohet lëshuesit të kësaj dosjeje të tenderit. Autoriteti Kontraktues, siç tregohet në ITT, lëshon këtë dosje tenderi për prokurimin e mallrave ose shërbimeve. Me përjashtim të rasteve kur tregohet ndryshe në shkresën ITT, Autoriteti Kontraktues prokuron vetëm në emrin e tij.
- ii. "Ofertues" i referohet çdo personi juridik që mund të paraqesë, ose ka paraqitur, një Ofertë për furnizimin e mallrave ose shërbimeve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.
- iii. "Konsulent" do të thotë një firmë këshilluese profesionale e themeluar ligjërisht ose një subjekt që mund të ofrojë ose ofron Shërbimet tek Autoriteti Kontraktues sipas Kontratës.
- iv. "Fleta e të dhënave" i referohet një pjese të tillë të udhëzimeve për ofertuesit të përdorura për të pasqyruar kushtet e procesit të tenderimit që janë specifike për kërkesat e ITT-së.
- v. "Udhëzime për Ofertuesit" i referohet grupit të plotë të dokumenteve, i cili u siguron Ofertuesve të gjithë informacionin e nevojshëm dhe procedurat që duhet të ndiqen gjatë përgatitjes së Ofertës së tyre.
- vi. "ITT" i referohet Ftesës për Tender që përbëhet nga udhëzime dhe referenca të përgatitura nga Autoriteti Kontraktues për qëllime të zgjedhjes së furnizuesit ose ofruesit të shërbimit më të mirë për të përmbushur kërkesat e treguara në Specifikimet Teknike.
- vii. "Shërbime" i referohet të gjithë fushës së detyrave që lidhen ose ndihmëse me përfundimin ose dorëzimin e mallrave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues sipas ITT-së.
- viii. "Numri i referencës" i referohet numrit të identifikimit të këtij aktiviteti të prokurimit të treguar në shkresën e ITT.
- ix. "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike, përveçse kur specifikohet ndryshe si "Dita e punës". Një ditë pune është çdo ditë që është një ditë zyrtare pune e Ofertuesit. Përfshihen festat zyrtare të ofertuesit.
- x. "Ekspertë kryesorë" është një profesionist, aftësitë, kualifikimet, njohuritë dhe përvoja e të cilit janë kritike për kryerjen e Shërbimeve sipas Kontratës dhe CV-ja e të cilit merret parasysh në vlerësimin teknik të propozimit të ofertuesit.
- xi. "Propozim" nënkupton Propozimin Teknik dhe Propozimin Financiar të Ofertuesit.
- xii. "Termat e Referencës (TOR)" do të thotë Termat e Referencës që shpjegojnë objektivat, fushëveprimin e punës, aktivitetet dhe detyrat që do të kryhen, përgjegjësitë përkatëse të Autoritetit Kontraktues dhe Ofertuesit, si dhe rezultatet dhe dorëzimet e pritshme të detyrës.

3. Dispozita të Përgjithshme

- i. Ky prokurim kryhet në përputhje me rregullat dhe praktikën e Politikës së Prokurimit të Autoritetit Kontraktues të lëshuara dhe në përputhje me rregullat, praktikën dhe udhëzimet e donatorëve të saj për kryerjen e aktiviteteve të prokurimit.
- ii. Objektivi kryesor i Autoritetit Kontraktues për prokurimin, është një politikë e konkurrencës së hapur dhe të ndershme për të gjithë ofertuesit që ofrojnë furnizime ose shërbime, dhe punonjësit e Autoritetit Kontraktues të përfshirë në prokurim do të kryejnë të gjithë biznesin me ndershmëri, drejtësi, integritet dhe transparencë.
- iii. Ofertuesit do t'iu përmbahen të gjitha kërkesave të kësaj oferte, duke përfshirë çdo ndryshim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- iv. Gjatë përgatitjes së ofertës, ofertuesit pritët të shqyrtojnë në detaje ITT-në. Mangësitë materiale në dhënien e informacionit të kërkuar në ITT mund të rezultojnë në refuzimin e ofertës.
- v. Ofertuesit duhet të kontrollojnë nëse të gjitha dokumentet e listuara në ftesën për tender janë marrë dhe janë të plota në të gjitha aspektet. Asnjë pretendim nuk do të shqyrtohet nga Autoriteti Kontraktues që rrjedh nga mosstudimi i detajeve të përmbajtura këtu ose për të marrë një informacion të tillë.

- vi. Ofertat e pranuara pas datës së marrjes së ofertave të përcaktuara në ftesën për tender ose jo rigorozisht në përputhje me këto udhëzime, mund, sipas gjykimit të vetëm të Autoritetit Kontraktues, të shpërfillen dhe të kthehen.
- vii. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të refuzojë ndonjë ose të gjitha ofertat e pranuara ose të kërkojë shpjegime të mëtejshme nga ofertuesit.
- viii. Para dhënies, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga ofertuesit që të japin informata shtesë ose të kërkojnë një intervistë të shpejtë për të lehtësuar procesin e vlerësimit.

4. Konflikti i interesit

- i. Ofertuesi nuk duhet të preket nga ndonjë konflikt interesi dhe nuk duhet të ketë lidhje ekuivalente në këtë drejtim me ofertuesit ose palët e tjera të përfshira në projekt.
- ii. Ofertuesi ka detyrimin t'ia zbulojë Autoritetit Kontraktues çdo situatë të konfliktit aktual ose potencial që ofertuesi mund të ketë me Autoritetin Kontraktues, bordin e tij drejtues ose zyrtarët ose punonjësit e emëruar përpara dorëzimit të ofertës që ndikon në aftësinë e tij për t'i shërbyer interesit më të mirë të Autoritetit Kontraktues. Mosdeklarimi i situatave të tilla mund të çojë në diskualifikimin e ofertuesit ose ndërprerjen e Kontratës së tij.

5. Avantazh i padrejtë konkurrues

- i. Drejtësia dhe transparencja në procesin e përzgjedhjes kërkojnë që ofertuesi ose bashkëpunëtorët e tyre që konkurrojnë për një detyrë specifike të mos nxjerrin një avantazh konkurrues nga ofrimi i shërbimeve ose mallrave në lidhje me detyrën në fjalë.

6. Mashtrimi dhe korrupsioni

- i. Autoriteti Kontraktues kërkon që ofertuesit, furnizuesit dhe kontraktuesit dhe nënkontraktuesit e tyre të respektojnë standardet më të larta të etikës gjatë prokurimit dhe ekzekutimit të kontratave të Autoritetit Kontraktues.
- ii. Autoriteti Kontraktues zbaton në mënyrë rigoroze një politikë të tolerancës zero ndaj mashtrimit, korrupsionit, bashkëpunimit, praktikave joetike dhe joprofesionale. Prandaj, ofertuesve u kërkohet të mos dërgojnë dhurata ose të mos ofrojnë mikpritje për personelin e Autoritetit Kontraktues.
- iii. Çdo përpjekje nga një ofertues për të marrë informacion konfidencial, për të lidhur marrëveshje të paligjshme me konkurrentët ose për të ndikuar në Komisionin e Vlerësimit ose Autoritetin Kontraktues gjatë procesit të shqyrtimit, sqarimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve do të çojë në refuzimin e ofertës së tij dhe mund të rezultojë në dënime administrative.
- iv. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën për të pezulluar ose anuluar procedurën, nëse konstaton se një ofertues i rekomanduar për dhënie është angazhuar në praktika korruptive, mashtruese, koluzive, shtrënguese, penguese ose joetike gjatë konkurrimit për kontratën në fjalë.

7. Struktura dhe përmbajtja e dosjes së tenderit

Seksioni 1	Ftesë për tender (ITT)
Seksioni 2	Udhëzime për ofertuesit
Seksioni 3	Fleta e të dhënave dhe specifikimet teknike
Seksioni 4	Letra motivuese dhe deklarata e nderit
Seksioni 5	Formularët e Dorëzimit Teknik dhe Financiar
Seksioni 6	Modeli i kontratës së propozuar

8. Orari i parashikuar

	DATA	KOHA
Afati për të kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktues	7 gusht 2026	17:00

Data e fundit në të cilën lëshohen sqarime nga Autoriteti Kontraktues	11 gusht 2026	17:00
Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve	21 gusht 2026	17:00
Njoftimi i dhënies ndaj ofertuesit të suksesshëm	24 gusht 2026	NA
Nënshkrimi i kontratës	25 gusht 2026	NA

9. Pjesëmarrja

- Pjesëmarrja në këtë procedurë tenderimi është e hapur për të gjithë ofertuesit. Për qëllime të vërtetimit të pajtueshmërisë me këtë rregull, ofertuesve që janë persona juridikë, do t'u kërkohej të paraqesin dokumentet e kërkuara sipas ligjit të atij vendi.
- Për t'u kualifikuar për të marrë pjesë në këtë procedurë tenderimi, ofertuesit duhet të dëshmojnë për kënaqësinë e Autoritetit Kontraktues se ata janë në përputhje me kërkesat e nevojshme ligjore, teknike dhe financiare dhe kanë mjetet për të kryer kontratën në mënyrë efektive.
- Nën-kontraktimi nuk lejohet.
- Procedura e tenderit konsiderohet e vlefshme nëse ka të paktën një kandidat/ofertues të përshtatshëm.

10. Sqarime

- Ofertuesit mund të kërkojnë sqarimin e ndonjë prej dokumenteve të ITT jo më vonë se data e treguar në Orarin, përpara datës së dorëzimit të Ofertës. Çdo kërkesë për sqarim duhet të dërgohet me shkrim në adresën e Autoritetit Kontraktues të treguar në Letrën e Ftesës. Autoriteti Kontraktues do t'i përgjigjet ofertuesit. Pas kësaj, sqarimi do të publikohet në faqen e internetit të RrGK-së.
- Autoriteti Kontraktues do të përpikjet të japë përgjigje të tilla ndaj sqarimeve në mënyrë të shpejtë, por çdo vonesë në një përgjigje të tillë nuk do të shkaktojë një detyrim nga ana e Autoritetit Kontraktues për të zgjatur datën e dorëzimit të ofertës, përveç rasteve kur Autoriteti Kontraktues gjykon se një shtyrje e tillë është e justifikuar dhe e nevojshme.

11. Ndryshimi i ofertës

- Në çdo kohë para afatit për dorëzimin e Ofertës, Autoriteti Kontraktues mund të modifikojë ITT-në për çfarëdo arsye, si përgjigje ndaj një sqarimi të kërkuar nga një Ofertues, në formën e një Informacioni Plotësues në ITT.
- Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të modifikojë dispozitat e këtij ITT në çdo kohë para datës së planifikuar për përgjigjet me shkrim. Fushëveprimi dhe kërkesat shtesë mund të shtohen. Njoftimi për këto ndryshime do t'u ofrohet të gjithë ofertuesve dhe do të publikohet në faqen e internetit të RrGK-së.
- Për t'u dhënë ofertuesve të ardhshëm kohë të arsyeshme për të shqyrtuar ndryshimet në përgatitjen e ofertës së tyre, Autoriteti Kontraktues, sipas gjykimit të tij, mund të shtyjë afatin për dorëzimin e ofertës, nëse natyra e ndryshimit në ITT e justifikon një shtyrje të tillë.

12. Përgatitja e ofertës

13.1. Kostoja

- Asnjë kosto e kryer nga ofertuesi në përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës nuk rimbursohet.
- Ofertuesi do të bartë të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e Ofertës së tij, dhe Autoriteti Kontraktues nuk do të jetë përgjegjës për ato kosto, pavarësisht nga mbajtja ose rezultati i procesit të përzgjedhjes.

13.2. Gjuha

- i. Oferta, si dhe çdo dhe të gjitha korrespondencat përkatëse të shkëmbyera nga Ofertuesi dhe Autoriteti Kontraktues, do të shkruhen në gjuhët e specifikuar në Fletën e të Dhënave.

13. Formulari i Dorëzimit të Ofertës

- i. Propozimi Teknik do të përgatitet duke përdorur formularin standard të dhënë dhe do të përmbajë dokumentet që do të dorëzohen të listuara në fletën e të dhënave.
- ii. Propozimi Financiar do të përgatitet duke përdorur formularin standard të dhënë. Do të listojë të gjitha kostot që lidhen me detyrën.
- iii. Ofertuesit duhet të plotësojnë, nënshkruajnë dhe dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:
 - 1) Formulari i Propozimit Teknik (Seksioni 5.1)
 - 2) Formulari i Propozimit Financiar (Seksioni 5.2)
 - 3) Seksioni 4: Letra motivuese dhe deklarata e nderit e kritereve të përjashtimit dhe mungesës së konfliktit të interesit

14. Formati dhe përmbajtja e ofertës teknike

- i. Gjatë përgatitjes së ofertës, ofertuesi pritët të shqyrtojë në detaje ITT-në. Mangësitë materiale në dhënie e informacionit të kërkuar në ITT mund të rezultojnë në refuzimin e ofertës.

15. Oferta financiare

- i. Oferta Financiare do të përgatitet duke përdorur formularin standard të bashkangjitur (5.1), duke shtuar detaje nëse është e nevojshme. Ai do të rendisë të gjithë komponentët kryesorë të kostos që lidhen me mallrat dhe shërbimet përkatëse, si dhe ndarjen e detajuar të këtyre kostove. Të gjitha mallrat dhe shërbimet e përshkruara në ofertën teknike duhet të çmohen veçmas në një korrespondencë një-me-një.
- ii. Oferta financiare do të llogaritet mbi bazën e dorëzimit në vend [dap] për mallrat dhe shërbimet përkatëse të ofruara.
- iii. Çdo punim dhe aktivitet i përshkruar në Ofertën Teknike, por jo me çmim në Ofertën Financiare, do të supozohet të përfshihet në çmimet e artikujve ose aktiviteteve, si dhe në çmimin total përfundimtar të ofertës.

16. Valuta

- i. Tenderët duhet të paraqiten në Euro.

17. Dokumentet që përcaktojnë përshtatshmërinë dhe kualifikimet e ofertuesit

17.1. Formulari i Dorëzimit të Tenderit

Përshtatshmëria do të përcaktohet në bazë të:

- i. Propozimit teknik
- ii. Propozimit Financiar
- iii. Seksioni 4: Letra motivuese dhe deklarata e nderit e kritereve të përjashtimit dhe mungesës së konfliktit të interesit

17.2 Refuzimi i tenderëve

Oferta e ofertuesit mund të refuzohet nëse ofertuesi nuk jep informacion të qartë dhe transparent në lidhje me situatat e mëposhtme:

- i. Ofertuesi, një drejtor, partner ose çdo person tjetër me kompetenca përfaqësimi është dënuar ose është nën hetim disiplinor për konkurrencë të paligjshme, shkelje të sekreteve tregtare, përvetësim ose keqpërdorim të pronës intelektuale ose keqpërdorim ose zbulim të paaautorizuar të informacionit të brendshëm të Punëdhënësit (ofertuesit) ose Kontraktuesve të tjerë.
- ii. Është, në dy (2) vitet e fundit, gjykuar të jetë i falimentuar ose i paaftë për të paguar nga një gjykatë e juridiksionit kompetent ose aktualisht i nënhtrohet procedurave: (i) për një deklaratë falimentimi, (ii) për një urdhër për mbyllje ose administrim të detyrueshëm nga gjykata ose (iii) të çdo procedure tjetër të ngjashme sipas ligjit të Kosovës ose ndonjë juridiksioni tjetër.
- iii. Ofertat e paraqitura nga dy (2) ose më shumë Ofertues do të refuzohen të gjitha nga Autoriteti Kontraktues nëse konstatohet se kanë ndonjë nga sa më poshtë:
 - 1) kanë të paktën një partner kontrollues, drejtor ose aksionar të përbashkët; ose
 - 2) ndonjëri prej tyre merr ose ka marrë ndonjë subvencion të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga tjetri; ose
 - 3) kanë të njëjtin përfaqësues ligjor për qëllime të kësaj ITT-je.

17.3 Arsye të tjera për refuzimin e tenderëve

Oferta mund të refuzohet gjithashtu për mos demonstrimin e kapacitetit/aftësisë teknike të përshtatshme dhe/ose përmbushjen e kërkesave të pranueshmërisë, duke përfshirë:

- i. Mosrespektimi i kërkesave për dorëzimin e tenderit.
- ii. Nëse tenderi nuk është në përputhje me specifikimet dhe/ose kërkesat e tjera thelbësore.

18. Periudha e vlefshmërisë

- i. Ofertat do të mbeten të vlefshme për periudhën e specifikuar në fletën e të dhënave, duke filluar nga data e afatit të dorëzimit të treguar edhe në orar. Një ofertë e vlefshme për një periudhë më të shkurtër do të refuzohet menjëherë nga Autoriteti Kontraktues dhe do të bëhet jo e përgjegjshme.
- ii. Në rrethana të jashtëzakonshme, para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës, Autoriteti Kontraktues mund t'ju kërkojë ofertuesve të zgjasin periudhën e vlefshmërisë së ofertës së tyre. Kërkesa dhe përgjigjet do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen pjesë përbërëse e ofertës.

19. Dorëzimi, hapja dhe vlerësimi

19.1. Dorëzimi

- i. Ofertuesi duhet të paraqesë një ofertë të nënshkruar dhe të plotë, duke përfshirë dokumentet dhe formularët në përputhje me Fletën e të Dhënave.
- ii. Një përfaqësues i autorizuar i ofertuesit do të nënshkruajë letrat origjinale të dorëzimit në formatin e kërkuar si për Propozimin Teknik ashtu edhe për Propozimin Financiar.
- iii. Ofertuesit duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në adresën e emailit të deklaruar në letrën e Ftesës për Tender me lëndën e kësaj ITT të deklaruar në shkresën e Ftesës. Të gjitha dokumentet e paraqitura duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përshkruara në udhëzimet për ofertuesit.
- iv. Dokumentet e marra pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

19.2 Hapja e tenderëve

- i. Qëllimi i sesionit të hapjes është të kontrollojë nëse tenderët janë të plotë, nëse dokumentet e kërkuara janë përfshirë siç duhet dhe nëse tenderët janë përgjithësisht në rregull.
- ii. Tenderët do të hapen në një seancë të kufizuar nga komisioni i emëruar.

- iii. Informacioni në lidhje me ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e Ofertës dhe rekomandimin e dhënies së kontratës, nuk do t'u zbulohet ofertuesve ose ndonjë personi tjetër që nuk ka të bëjë zyrtarisht me një proces të tillë, as pas publikimit të dhënies së kontratës.

19.3 Shqyrtimi paraprak i ofertës

- i. Qëllimi në këtë fazë është të kontrollohet nëse tenderët janë në përputhje me kërkesat thelbësore të dosjes së tenderit. Një tender konsiderohet se është në përputhje nëse plotëson të gjitha kushtet, procedurat dhe specifikimet në dosjen e tenderit pa u larguar ose duke iu bashkangjitur atyre kufizime.
- ii. Nëse një tender nuk është në përputhje me dosjen e tenderit, ai do të refuzohet menjëherë dhe më pas nuk mund të bëhet në përputhje me korrigjimin e tij ose tërheqjen e devijimit ose kufizimit.
- iii. Autoriteti Kontraktues do të shqyrtojë Ofertën për të përcaktuar nëse ato janë të plota në lidhje me kërkesat minimale të dokumentacionit, nëse dokumentet janë nënshkruar siç duhet, nëse Ofertuesi është apo jo në listën e sanksioneve të terroristëve dhe financuesve të terrorizmit, dhe në listën e Autoriteteve Kontraktuese të shitësve të pezulluar dhe të larguar, dhe nëse Oferta është në rregull, midis treguesve të tjerë që mund të përdoren në këtë fazë. Autoriteti Kontraktues mund të refuzojë çdo ofertë në këtë fazë.
- iv. Përcaktimi i përgjegjësisë së Autoritetit Kontraktues për një Ofertë do të bazohet në përmbajtjen e vetë Ofertës.
- v. Një ofertë me përgjegjësi të konsiderueshme është ajo që përputhet me të gjitha kushtet dhe specifikimet e ITT-së pa devijim, rezervim ose mosveprim material.
- vi. Nëse një ofertë nuk është thelbësisht e përgjegjshme, ajo do të refuzohet nga Autoriteti Kontraktues dhe nuk mund të bëhet më pas e përgjegjshme nga Ofertuesi me korrigjimin e devijimit, rezervimit ose mosveprimin material.
- vii. Vetëm ato oferta që përputhen me kriteret e pranueshmërisë do të merren parasysh për vlerësim të mëtejshëm teknik.

19.4 Vlerësimi i ofertës

- i. Pas analizimit të ofertave që konsiderohen të jenë në përputhje në aspektin administrativ, komisioni i vlerësimit do të vendosë për pranueshmërinë teknike të secilit tender, duke e klasifikuar atë si teknikisht në përputhje ose në mospërputhje.
- ii. komisioni i vlerësimit të Autoritetit Kontraktues do të vlerësojë Propozimet Teknike në bazë të përgjegjshmërisë së tyre ndaj Termave të Referencës dhe ITT-së, duke zbatuar kriteret e vlerësimit, nën-kriteret dhe sistemin e pikëve të specifikuar në Kriteret e Dhënies. Çdo ofertuesi të përgjegjshëm do t'i jepet një rezultat teknik dhe financiar.
- iii. Në interes të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe për të lehtësuar shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, komisioni i vlerësimit mund t'i kërkojë secilit ofertues individualisht sqarimin e ofertës së tij, duke përfshirë zbërthimin e çmimeve, brenda një afati të arsyeshëm që do të caktohet nga komisioni i vlerësimit. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të jetë me shkrim, por nuk mund të kërkohej, ofrohet ose lejohet asnjë ndryshim në çmim ose substancë të tenderit, përveçse kur kërkohej për të konfirmuar korrigjimin e gabimeve aritmetike të zbuluara gjatë vlerësimit të tenderëve. Çdo kërkesë e tillë për sqarim nuk duhet të shtrembërojë konkurrencën. Vendimet që tregojnë se një ofertë nuk është teknikisht në përputhje duhet të justifikohen siç duhet në procesverbalin e vlerësimit.

19.5 Vlerësimi financiar

- i. Tenderët që rezultojnë teknikisht të pajtueshëm do të kontrollohen për çdo gabim aritmetik në llogaritje dhe përmbledhje. Gabimet do të korrigjohen nga komisioni i vlerësimit si më poshtë:
 - 1) kur ka mospërputhje midis shumave në shifra dhe në fjalë, shumat në fjalë do të jetë shumat e marrë në konsideratë;

- 2) me përjashtim të kontratave paushall, ku ka mospërputhje midis një çmimi për njësi dhe shumës totale që rrjedh nga shumëzimi i çmimit për njësi dhe sasisë, çmimi për njësi siç citohet do të jetë çmimi i marrë parasysh.
- ii. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë do të jenë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, tenderi i tij do të refuzohet.
- iii. Nëse nuk specifikohet ndryshe, qëllimi i procesit të vlerësimit financiar është identifikimi i ofertuesit që ofron çmimin më të ulët. Kur specifikohet në specifikimet teknike, vlerësimi i tenderëve mund të marrë parasysh jo vetëm kostot e blerjes, por, në masën përkatëse, kostot e bartura gjatë ciklit jetësor të furnizimeve (të tilla siç janë për shembull kostot e mirëmbajtjes dhe kostot operative), në përputhje me specifikimet teknike. Në këtë rast, autoriteti kontraktues do të shqyrtojë në detaje të gjithë informacionin e ofruar nga ofertuesit dhe do të formulojë gjykimin e tij bazuar në koston totale më të ulët, duke përfshirë kostot shtesë.

20. Tërheqja, zëvendësimi dhe modifikimi i ofertës

- i. Ofertuesit pritet të kenë përgjegjësinë e vetme për të ndërmarrë hapa për të shqyrtuar me kujdes konsistencën e plotë të Ofertës së saj me kërkesat e ITT-së, duke pasur parasysh se mangësitë materiale në sigurimin e informacionit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, ose mungesa e qartësisë në përshkrimin e mallrave dhe shërbimeve përkatëse që do të ofrohen, mund të rezultojnë në refuzimin e Ofertës. Ofertuesi do të marrë përsipër çdo përgjegjësi në lidhje me interpretimet ose konkluzionet e gabuara të bëra nga Ofertuesi duke kuptuar ITT-në e dhënë nga Autoriteti Kontraktues.
- ii. Një ofertues mund të tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë ofertën e tij pasi të jetë dorëzuar duke anuluar ose ridërguar ofertën e tij.

21. Konfidencialiteti

- i. Informacioni në lidhje me ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e Ofertës dhe rekomandimi i dhënies së kontratës nuk do të zbulohet ofertuesve ose ndonjë personi tjetër që nuk ka të bëjë zyrtarisht me një proces të tillë, edhe pas dhënies së kontratës.
- ii. Çdo përpjekje nga një Ofertues për të ndikuar tek Autoriteti Kontraktues në shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertës ose vendimeve të dhënies së kontratës mund të rezultojë, me vendimin e Autoritetit Kontraktues, në refuzimin e ofertës së tij.

22. Dhënia e Kontratës

22.1 E drejta për të pranuar, refuzuar ose marrë si të papërgjegjshme ndonjë ose të gjitha ofertat

- i. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të pranojë ose refuzojë çdo Ofertë, të marrë një ose të gjitha Ofertat si jo të përgjegjshme dhe të refuzojë të gjitha Ofertat në çdo kohë para shpalljes së kontratës fituese, pa shkaktuar asnjë përgjegjësi, ose detyrim për të informuar Ofertuesin(at) e prekur për arsyet e veprimit të Autoritetit Kontraktues. Më tej, Autoriteti Kontraktues nuk është i detyruar t'ia japë kontratën ofertës me çmim më të ulët.

22.2 Kriteret e dhënies

- i. Para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës, Autoriteti Kontraktues do t'ia japë kontratën Ofertuesit të kualifikuar dhe të pranueshëm që konstatohet se i përgjigjet kërkesave të Specifikimit Teknik dhe ka marrë pikët më të larta kundrejt kriterëve të dhënies.

Nënshkrimi i kontratës

- i. Brenda pesë ditëve nga data e marrjes së Kontratës, Ofertuesi i suksesshëm do të nënshkruajë Kontratën.

22.4 Komente për ofertuesit e pasuksesshëm

- i. Autoriteti Kontraktues synon të ofrojë komente për çdo ofertues që paraqet një ofertë të pasuksesshme. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të kontrollojë formatin dhe përmbajtjen e çdo informimi të tillë dhe ta kufizojë atë në çfarëdo mënyre që besohet nga Autoriteti Kontraktues të jetë i përshtatshëm (që përfshin, në rrethana të jashtëzakonshme, të drejtën për të refuzuar një informim pa dhënë ndonjë arsye për ta bërë këtë).

22.5 Ankesat

- i. Ofertuesit që vlerësojnë se janë trajtuar në mënyrë të padrejtë mund të paraqesin ankesë pranë Autoritetit Kontraktues.
- ii. Për çdo arsye të paraqitjes së ankesës, ato duhet të paraqiten brenda pesë ditëve nga dita e njoftimit të palëve, përkatësisht kur është bërë njoftimi zyrtar në lidhje me procedurën. Ankesat duhet t'i paraqiten Autoritetit Kontraktues, i cili do të vendosë për ankesat eventuale jo më vonë se pesë ditë nga dita e paraqitjes së ankesës.